



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 26-09-2025
Nr. 5/2173

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4 dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë dhe Udhëzimit administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, kërkesës nr. 5/2173 të datës 10.06.2025 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji “Biznesi”, nxjerr:

V E N D I M
Për rilicencimin e Kolegjit “Biznesi”

1. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji “Biznesi” në Prishtinë, rilicencohet për periudhën trevjeçare 2025-2028 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), me programet e studimit:
 - 1.1. Juridik LLB 240 ECTS (R) me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;
 - 1.2. Menaxhimi i Emergjencave BA 180 ECTS (R) me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik.
2. Bartësi privat i arsimit të lartë, Kolegjit ‘Biznesi’ në Prishtinë, sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim ose tejkalim të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka shqyrtuar kërkesën me nr. 5/2173 të datës 10.06.2025 të parashtruar nga BPrAL Kolegji “Biznesi”, dhe vendimit të Agjencionit të Kosovës për Akreditim me nr. ref. 451/25 e dt. 22.04.2025,

Licenca e Kolegjit "Biznesi" zgjat sipas dispozitivit të këtij vendimi si në nivel institucional dhe të programeve të studimit duke u bazuar në vendimet e nxjerra nga AKA.

Komisioni për Licencim dhe rilicencim në MASHTI duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin për aplikim, kërkon nga Kolegji "Biznesi" që brenda vitit kalendarik deri më 01 shtator 2026 të ofroj vendimin për ndryshim të destinacionit nga ai afarist në veprimtari arsimore nga organi kompetent Drejtoria e Urbanizmit -Komuna e Prishtinës.

Nëse brenda vitit kalendarik nuk dorëzohet vendimi i ridestinimit nga organi kompetent - Drejtoria e Urbanizmit, Kolegjit Biznesi, me Qendrën në Prishtinë, nuk i lejohet regjistrimi i studentëve për vitin akademik 2026/2027.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit "Biznesi";
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA;
7. Arkivit.

Kryetar i Komisionit
Burim Gashi

